



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 13

Tiranë – E mërkurë, 1 shkurt 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 20.1.2017	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve nr. 6173, datë 3.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 71, datë 27.1.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 324, datë 28.1.2016, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	1335
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 23.1.2017	Me objekt shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e fjalisë së dytë të paragrafit të parë të nenit 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.....	1342
Njoftim i Ministrisë së Punëve të Jashtme nr. 820, datë 20.1.2017	Mbi hyrjen në fuqi të disa marrëveshjeve ndërkombëtare.....	1346



VENDIM
Nr. 3, datë 20.1.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 1.12.2016 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 74/13, Akti që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Jon” sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Raif Halidini, Bashkia Tiranë, Njësia Administrative Kashar

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 6173, datë 3.6.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 71, datë 27.1.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë; nr. 324, datë 28.1.2016 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 41/1, 42, 43, 131/f dhe 134/1/h të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6/1 dhe 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 28, 29 dhe 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, që kërkoj pranimin e kërkesës, dhe pretendimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Raif Halidini dhe Bashkia Tiranë, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësja, shoqëria “Jon” sh.p.k., në vitin 2010 ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje për ndërtimin e një godine banimi me shtetasin B.D.,

pronar i një sipërfaqe toke prej 4028 m², e ndodhur në Yzberisht, Tiranë, e regjistruar në ZRPP. Leja e sheshit dhe e ndërtimit të objektit është miratuar me vendimin nr. 21, datë 3.2.2011 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Komunës Kashar.

2. Subjekti i interesuar Raif Halidini ka legalizuar një objekt banimi njëkatësh me sipërfaqe ndërtimi 106.6 m² dhe sipërfaqe ndërtimore 311.2 m², kjo e fundit e blerë nga ALUIZNI me kontratën e shitblerjes nr. 4797 rep., nr. 2509 kol., datë 8.8.2012. Me pretendimin se leja e ndërtimit është e pavlefshme, subjekti i interesuar Raif Halidini i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt: “*Anulimin e lejes së ndërtimit dhe detyrimin e të paditurve shoqëria “Jon” dhe Komuna Kashar ta njohin paditësin si pronar mbi truallin dhe ndërtesën.*”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6173, datë 3.6.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, anulimin e lejes së ndërtimit, si dhe detyrimin e të paditurve ta njohin paditësin pronar në ndërtesën e legalizuar nga ALUIZNI.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2640, datë 13.12.2013, ka vendosur moskompetencën për gjykimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

4. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, pasi ka shqyrtuar në dhomën e këshillimit ankimin e paraqitur nga Komuna Kashar, me vendimin nr. 71, datë 27.1.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e kërkuases për pezullimin e zbatimit të vendimeve të mësipërme, me vendimin nr. 107, datë 15.4.2014, ka vendosur pranimin e kërkesës. Në lidhje me rekursin e paraqitura nga kërkuësja dhe komuna Kashar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2016-324, datë 28.1.2016, ka vendosur mospranimin e tyre, në dhomën e këshillimit.

II

6. **Kërkuësja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 6.7.2016, duke pretenduar se vendimet e gjykatave të zakonshme nuk kanë respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor. Në mënyrë të përmbledhur, kërkuësja parashtron se është cenuar:



6.1 *E drejta e aksesit në gjykatë dhe e kontradiktoritetit në gjykim*, pasi Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në mënyrë të gabuar, ka vendosur mosshqyrtimin e themelit të çështjes me arsyetimin se ankimi ishte paraqitur nga një përfaqësues pa tagra. Ky qëndrim i gjykatës ka cenuar edhe parimin e barazisë së armëve. Ndonëse pretendimi në lidhje me cenimin e këtyre standardeve kushtetuese është parashtruar në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, Kolegji Administrativ nuk e ka marrë parasysh, duke vendosur mospranimin e rekursit.

6.2 *E drejta e ankimit*, pasi Gjykata Administrative e Apelit arsyeton se “*ankimi për zënie afati është paraqitur dhe nënshkruar nga përfaqësuesja me autorizim që nuk përmban në mënyrë të shprehur të drejtën për të bërë ankim*” pa marrë parasysh detyrimin e sekretarisë gjyqësore për plotësimin paraprakisht të kërkesave formale të ankimit. Këtë detyrim nuk e ka respektuar as Gjykata e Lartë, duke cenuar të drejtën për ankim efektiv.

6.3 *Standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet e gjykatave të zakonshme jo vetëm nuk përmbajnë një vijë logjike dhe ligjore për sa u takon fakteve, por ato nuk kanë marrë në analizë asnjë nga pretendimet që lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit procedural e material, si formimi i gabuar i ndërgjyqësisë, dispozitat ligjore që ka cenuar organi administrativ për nxjerrjen e lejes, parashkrimi i padisë, veprimi në kohë i fuqisë së aktit administrativ, etj. Këto pretendime janë paraqitur edhe në rekursin e depozituar në Gjykatën e Lartë, e cila nuk i ka konsideruar si shkak për pranimin e rekursit.

6.4 *Parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi vendimi për pranimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore është marrë nga pesë gjyqtarë, kurse vendimi për mospranimin e rekursit nga tre gjyqtarë.

6.5 *E drejta e pronës*, pasi leja e ndërtimit përbën “zotërim” si për shoqërinë dhe për pronarin e parcelës ndërtimore. Në këtë kuptim, leja e ndërtimit, duke krijuar aset kapital dhe vlera ekonomike, është pronë ekzistuese, referuar nenit 1 të protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

7. **Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë**, ka prapësuar me shkrim se:

7.1 Kërkesja edhe pse ka paguar taksën e infrastrukturës nuk është pajisur me formularin e

lejes së ndërtimit për objektin kompleks banimi dhe shërbimi, por me formularin nr. 2 të lejes së sheshit dhe vendimin e lejes së sheshit dhe ndërtimit nr. 21, datë 3.2.2011 miratuar nga KRRT-ja e Komunës Kashar në pronën e shtetasit B.D.

7.2 Zona ku përfshihet leja e mësipërme është zonë me studim urbanistik, e miratuar me vendimet nr. 1, datë 1.6.2006 dhe nr. 5, datë 3.9.2010 të Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë.

8. **Subjekti i interesuar, Raif Halidini**, ka prapësuar me shkrim si vijon:

8.1 Kërkesja nuk legjitimohet lidhur me pretendimet për cenimin e së drejtës për akses, të së drejtës së mbrojtjes dhe të së drejtës së ankimit, pasi nuk i ka ngritur ato në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, duke mos përmbushur kërkesën kushtetuese për shterimin e mjeteve juridike në dispozicion përpara vënies në lëvizje të gjykimit kushtetues.

8.2 Pretendimi për mosrespektimin e standardit kushtetues të arsytimit të vendimit është i pabazuar, pasi nisur edhe nga fakti se kërkesja nuk ka përmbushur të metat e ankimit brenda afatit procedural të vendosur nga Gjykata Administrative e Apelit, pretendimet konsiderohen të rëna në dekadencë, referuar nenit 459 të KPC-së. Në këto kushte, Gjykata e Lartë nuk mund të merrte në shqyrtim pretendimet për zbatimin e gabuar të ligjit procedural apo material, me pasojë cenimin e procesit të rregullt ligjor.

8.3 Po ashtu, i pabazuar është edhe pretendimi në lidhje me formimin e gabuar të ndërgjyqësisë, për shkak se nuk është thirrur në gjykim edhe ish-pronari i truallit me të cilin kërkesja kishte marrëveshjen për ndërtim. VKM-ja nr. 247, datë 13.4.2006 miratoi kalimin në pronësi të parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale, ku me numër rendor 451 renditej edhe pasuria objekt gjykimi. Për më tepër, jo vetëm që në kohën e ngritjes së padisë disponohej leja e legalizimit nr. 26338, datë 20.8.2012, por edhe VKM-ja nr. 869, datë 10.12.2014 “Për shpërblimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”, e shpronësonte shprehimisht shtetasin B.D. për pjesën që kishte mbivendosje



me subjektin e interesuar në pasurinë 215/186, zona kadastrale 3866, Yzberisht Tiranë. Sa më sipër ka sjellë edhe rënien nga fuqia të marrëveshjes me pronarin e truallit, çka do të thotë se kërkuesi nuk mund të pretendojë në këtë proces një të drejtë që nuk e gëzon më. Për më tepër, ZRRPP-ja, me urdhrin nr. 485, datë 13.10.2016, ka urdhëruar lirimimin e pasurive në pronësi të shtetasit B.D.

8.4 Sipas vendimit nr. 37, datë 10.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese për pajtueshmërinë me Kushtetutën të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” njihet interesi publik, që mund të justifikojë shpronësimin e pronarëve të ligjshëm dhe kalimin e pronave të tyre në pronësi të ndërtuesve të ndërtimeve pa leje.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për zëvendësimin procedural të subjektit të interesuar Komuna Kashar

9. Gjykata konstaton paraprakisht se bazuar në ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale në Republikën e Shqipërisë”, ndarja administrativo-territoriale e vendit bazohet në 12 qarqe dhe 61 bashki. Niveli i parë i qeverisjes vendore është riorganizuar me 61 njësi të qeverisjes vendore, nga 373 bashki dhe komuna që kishte para miratimit të ligjit, duke suprimuar komunën si njësi të qeverisjes vendore. Po ashtu, Gjykata vëren se sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, bashkia përbëhet nga disa njësi administrative sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale.

10. Bazuar në sa më sipër Gjykata çmon se për sa kohë subjekti i interesuar Komuna Kashar është suprimuar si e tillë dhe sipas legjislacionit në fuqi gëzon statusin juridik të njësisë administrative të Bashkisë Tiranë, referuar nenit 1/2, të ligjit nr. 8755, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 199/2 të Kodit të Procedurës Civile, me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt me ndërhyrës të përcaktuara qartë vlerësoi të nevojshëm kalimin procedural dhe marrjen pjesë të Bashkisë Tiranë në cilësinë e subjektit të interesuar.

B. Për legjitimimin e kërkueses

11. Kërkuësja është person juridik dhe si i tillë, bazuar në jurisprudencën kushtetuese, mund të jetë subjekt i të drejtave dhe lirive kushtetuese në nivel të kufizuar “për aq sa përputhen me qëllimet e përgjithshme të këtyre personave dhe me thelbin e këtyre të drejtave, lirive dhe detyrimeve”, në kuptim të nenit 16/2 të Kushtetutës. Disa nga këto liri dhe të drejta nuk është e mundur t’i atribuohen një personi juridik, për shkak të thelbit të tyre ose qëllimit për të cilin ligji i ka dhënë jetë personit juridik. Për sa u përket të drejtave të tjera, personi juridik mund të jetë subjekt i tyre në atë masë dhe në atë kuptim që ato lehtësojnë gëzimin e plotë të këtyre të drejtave dhe lirive për individët (*shih vendimin nr. 19, datë 9.7.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Për të vlerësuar legjitimimin e personave juridikë, Gjykata bazohet në të njëjtat elemente që merren në konsideratë për legjitimimin e individëve, në referim të neneve 131/f dhe 134 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, kërkuësja, shoqëria “Jon” sh.p.k., mund të vërë në lëvizje juridiksionin kushtetues për çështje që lidhen me interesat e saj, kur pretendon se i janë cenuar të drejtat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike. Kërkesat për shkeljen e të drejtave kushtetuese paraqiten jo më vonë se 2 vjet nga konstatimi i shkeljes, rregull ky i parashikuar nga ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

13. Në vështrim të standardeve të mësipërme dhe bazuar në rrethanat e çështjes, Gjykata vlerëson se kërkuësja i përmbush kriteret për legjitimimin *ratione personae*, pasi pretendimet e saj përfshihen në rregullimin kushtetues të neneve 131/f dhe 134 të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor.

14. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae* të kërkueses, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 22, datë 22.7.2009; nr. 31, datë 5.7.2011 të Gjykatës*



Kushtetuese). Bazuar në jurisprudencën kushtetuese, Gjykata ndërhyr në ato raste kur, përmes veprimeve të tyre, gjykatat e zakonshme cenojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve dhe të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata e analizon ligjin, faktin dhe rrethanën përkatëse në atë dimension që ka ndikim mbi të drejtat dhe liritë e parashikuara nga nenet 42 dhe 131/f të Kushtetutës, gjë e cila përbën juridiksionin e saj kushtetues. Detyra e Gjykatës nuk është zgjidhja e një mosmarrëveshjeje juridike për çështje fakti, por identifikimi i fakteve të natyrës kushtetuese, të cilat shërbejnë për realizimin e kompetencave të saj dhe përbëjnë elementin thelbësor në përcaktimin e autoritetit të një gjykimi kushtetues (*shih vendimet nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 16, datë 19.4.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin në shqyrtim, Gjykata çmon se kërkesja, shoqëria “Jon” sh.p.k., nuk ka në dispozicion mjet tjetër për të kundërshtuar vendimet gjyqësore. Për këtë arsye ajo legjitimohet t’i drejtohet me kërkesë kësaj Gjykate. Gjithashtu, pretendimet e kërkeses në lidhje me cenimin e së drejtës së aksesit, të drejtës së ankimit, të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, të standardit të arsyetimit dhe të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, *prima facie* bien në fushën e veprimit të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, prandaj ato do të shqyrtohen në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit, të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, si dhe të ankimit

16. Kërkesja ka pretenduar se arsyetimi i Gjykatës Administrative të Apelit se ankimi ishte paraqitur nga përfaqësuesja ligjore pa e pasur këtë tagër, i ka mohuar të drejtën për akses në gjykim, si dhe parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetin. Sipas kërkeses, edhe pse pretendimi për cenimin e këtyre standardeve të së drejtës për një proces të rregullt ligjor ishte parashtruar në rekurs, Kolegji Administrativ nuk e mori në analizë duke vendosur mospranimin e rekursit.

17. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimin nr. 31, datë 26.5.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Mohimi i së drejtës për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor. E drejta për t’iu drejtuar gjykatës, si një nga elementet më të rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimin nr. 25, datë 10.5.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Nga ana tjetër, parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t’u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t’u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njëjës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të



barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 34, datë 29.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Duke iu rikthyer çështjes konkrete Gjykata vëren se nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, kërkuesja, shoqëria “Jon” sh.p.k., ka paraqitur fillimisht ankim (për zënie afati) kundër vendimit nr. 6173, datë 3.6.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke argumentuar se *“...këtë vendim e kundërshtojmë brenda afatit ligjor si një vendim të padrejtë, të pambështetur në prova dhe në ligj, shkaqet të cilat do t'i parashtrijmë në ankimin e plotë që do të dorëzohet në momentin e zbardhjes së vendimit”*. Ankimi, i cili është paraqitur në datën 11.6.2013, është nënshkruar nga M.K., e cila me autorizimin e datës 30.4.2013 të administratores së shoqërisë “Jon” autorizohet për të bërë përfaqësimin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në çështjen civile konkrete.

20. Po ashtu, Gjykata konstaton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6173, datë 8.7.2013, me objekt “Plotësim ankim”, ka njoftuar kërkuesen se *“ankimi i paraqitur nga ana juaj nuk i plotëson kriteret e nenit 454/c të KPC-së. Në këto kushte, në bazë të nenit 455, paragrafi i fundit, ju njoftojmë se brenda 5 ditëve duhet t'i plotësoni këto të meta”*.

21. Sipas aktit nr. 164 prot., datë 13.12.2013 “Autorizim”, i cili gjendet i administruar në dosje, rezulton se administratorja e shoqërisë “Jon” sh.p.k. ka autorizuar një tjetër përfaqësuese ligjore për mbrojtjen e interesave ligjorë në çështjen civile që do të gjykohej në Gjykatën e Apelit Tiranë. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 13.12.2013, Gjykata vëren se përfaqësuesja e kërkueses ka qenë e pranishme, por në këtë seancë nuk janë kryer veprime procedurale, pasi Gjykata e Apelit Tiranë ka deklaruar moskompetencën si rezultat i efekteve të vendimit unifikues nr. 3, datë 6.12.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke konkluduar se mosmarrëveshja civile do t'i dërgohet për shqyrtim Gjykatës Administrative.

22. Gjykata Administrative e Apelit në datën 8.1.2014 ka vendosur shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi dhe njoftimin e palëve për

zhvillimin e seancës në datën 27.1.2014, ku ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 6173, datë 8.7.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Midis të tjerash, Gjykata Administrative e Apelit në vendim arsyeton: *“Lidhur me kërkesën për zënie afati ankimi të paraqitur nga pala e paditur Jon sh.p.k., gjykata konstaton se edhe pas dhënies së afatit për plotësimin e të metave të ankimit nga gjykata e shkallës së parë, ankimi nga kejo palë nuk është paraqitur në formën e kërkuar procedurale sipas nenit 454 të KPC-së (mungojnë shkaqet për të cilat është bërë ankimi, palët ndërgjyqëse). Përpos këtij fakti rezulton se ankimi për zënie afati është paraqitur dhe nënshkruar nga përfaqësuesja me autorizim e shoqërisë, ndërkohë që autorizimi nr. 95, datë 30.4.2013 nuk përmban në mënyrë të shprehur të drejtën e përfaqësueses për të bërë ankim, në kundërshtim me nenin 97 të KPC-së. Për këto arsye, Gjykata konkludoi se ky ankim nuk duhet marrë në shqyrtim, pasi nuk plotëson kërkesat ligjore”*.

23. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për akses dhe të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit është i pabazuar. Kërkuesja ka marrë njoftim për procesin gjyqësor që do të zhvillohej në Gjykatën Administrative të Apelit me fletëthirrjen e datës 8.1.2014, e cila është nënshkruar nga administratorja e shoqërisë pa rezerva. Për më tepër, në përmbajtjen e njoftimit kërkuesja vihet në dijeni për të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve me shkrim lidhur me shkaqet e ankimit dhe kundër ankim deri në 5 ditë përpara datës së seancës. Nga aktet e dosjes gjyqësore nuk rezulton të jetë paraqitur ankim apo parashtrime shtesë nga kërkuesja, e drejtë e cila është ushtruar nga Komuna Kashar, pala tjetër e paditur në proces.

24. Në këtë kuptim, Gjykata vlerëson se procesi i zhvilluar nuk ngre dyshime për cenimin e së drejtës për ankim, që sipas kërkueses rezulton të jetë cenuar. Për sa kohë kërkuesja nuk ka shfrytëzuar mundësitë që ofron legjislacioni procedural administrativ, për të cilat ajo ka marrë dijeni efektivisht përmes fletëthirrjes dhe nuk ka paraqitur parashtrime apo ankim të plotë brenda afateve ligjore, pretendimet e saj për cenimin e së drejtës për akses dhe ankim efektiv, si dhe të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit janë të pabazuara.

D. Për pretendimin e cenimit të standardit kushtetues të arsyetimit të vendimit



25. Kërkuesja ka pretenduar gjithashtu se vendimet e gjykatave të zakonshme nuk përmbajnë një vijë logjike dhe ligjore për sa u takon fakteve. Sipas kërkueses, pretendimet që lidhen me zbatimin e gabuar të ligjit procedural dhe material si formimi i gabuar i ndërgjyqësisë, dispozitat ligjore që ka cenuar organi administrativ për nxjerrjen e lejes, parashkrimi i padisë, veprimi në kohë i fuqisë së aktit administrativ, nuk janë marrë në analizë nga asnjëra gjykatë, përfshi edhe Gjykatën e Lartë, edhe pse ishin parashtruar në rekurs.

26. Gjykata, në analizë të dispozitave kushtetuese dhe atyre procedurale, ka theksuar se vendimet gjyqësore duhet jenë të arsyetuara dhe të përmbajnë: një parashtrim të përmbledhur të rrethanave të faktit, provat mbi të cilat bazohen, arsytet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta, si dhe dispozitivin, duke treguar dispozitat ligjore të zbatuara. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsytet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve (*shih vendimin nr. 11, datë 2.4.2008; nr. 21, datë 4.4.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Zbatimin e këtij parimi Gjykata e ka vlerësuar rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërtënie, përmban referenca në

ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, si dhe masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr. 39, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata ka theksuar se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsytimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar (*shih vendimin nr. 39, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Edhe Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka theksuar: “detyrimi që ka gjykata vendase për të arsyetuar vendimet e saj, nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse. Masa e arsytimit të vendimit varet nga natyra e vendimit në fjalë. Arsyetimi i kufizuar i dhënë nga Gjykata e Lartë në formulimin e vendimit në dhomë këshillimi, në mënyrë të nënkuptuar evidenton se aplikanti nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës. Gjykata vëren se kur një gjykatë e lartë refuzon të pranojë një çështje, për arsye se mungojnë shkaqet ligjore për ngritjen e çështjes, një arsyetim shumë i kufizuar mund të përmbushë kriterin e nenit 6 të Konventës” (*Marini kundër Shqipërisë, datë 18.12.2007, §105-106; Mishajoni kundër Shqipërisë, datë 7.12.2010, § 51*).

30. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkueses kanë të bëjnë me çështje të natyrës ligjore dhe si të tilla i takojnë për zgjidhje gjykatave të zakonshme. Veçanërisht vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, ku ngrihen pretendimet për procesin e zhvilluar nga Gjykata Administrative e Apelit, në pjesën e tij hyrëse përmban palët ndërgjyqëse,



objektin e padisë, disponimet e gjykatave më të ulëta dhe shkaqet e rekursit të paraqitur nga pala e paditur në proces. Vendimi përmban edhe vlerësimin e Gjykatës së Lartë në lidhje me shkaqet e rekursit, si dhe argumentet që e kanë çuar atë në qëndrimin e shprehur në dispozitiv. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se vendimi i kundërshtuar nuk rezulton të jetë jologjik, të ketë kundërthënie, të mos ketë referencë në ligjin e zbatueshëm dhe të mos respektojë elementet e përmendura më sipër, duke përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimit objekt shqyrtimi. Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, shqyrton rekursin për pretendime të shkëlqes së ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të saj. Ajo analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuar. Në zbatim të parimit të subsidiaritetit, kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Raporti ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e kësaj Gjykate i kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit). Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (*shih vendimet nr. 4, datë 28.2.2006; nr. 32, datë 28.12.2009; nr. 58, datë 24.12.2012; nr. 36, datë 25.7.2013; nr. 52, datë 2.12.2013; nr. 42 datë 7.7.2014; nr. 62, datë 23.9.2015; nr. 37, datë 30.6.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Bazuar në sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimi i kërkuësës për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

E. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

32. Kërkuësja ka pretenduar cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj, duke argumentuar se vendimi për pranimin e kërkesës për pezullimin e zbatimit të vendimeve gjyqësore është marrë nga pesë gjyqtarë, kurse vendimi për mospranimin e rekursit nga tre gjyqtarë.

33. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 2, datë 22.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuësja nuk ka arritur ta ngrejë pretendimin në nivel kushtetues. Rregullimet e ndryshme procedurale, si dhe dallimet që ekzistojnë midis dy proceseve gjyqësore me objekt shqyrtimin e kërkesës për pezullim dhe shqyrtim rekursi, të pranuar këto edhe nga jurisprudenca kushtetuese, bëjnë që edhe ky pretendim të jetë i pabazuar.

35. Për arsyet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuësës për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, janë të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/h të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Altina Xhoxhaj, Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Fatos Lulo



VENDIM
Nr. 4, datë 23.1.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 24.11.2016 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 67/7, Akti që i përket:

KËRKUESE: Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

OBJEKTI: Shfuqizimi si e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i fjalisë së dytë të paragrafit të parë të nenit 3 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

BAZA LIGJORE: Nenet 134/1/dh dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekti të interesuar, Këshillit të Ministrave, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se shtetasi P.D. i është drejtuar gjykatës me padi me objekt: “*Anulimin e urdhrin nr. 3538, datë 2.12.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për lirimin tim nga detyra si të paligjshëm dhe*

pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë padrejtësisht.”, duke vendosur si bazë ligjore të padisë nenin 57 të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, “Për Policinë e Shtetit”, nenet 115/b, 118 dhe 119 të Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjin nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

2. Me vendimin nr. 987, datë 12.3.2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur: “*Pranimin e pjesbëm të padisë. Detyrimin e palës së paditur, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit Tiranë, të dëmshtëpërblejë paditësin P.D. me pagën e 12 muajve (neto). Rrëzimin e padisë për sa i përket pjesës tjetër të kërkuar si të pabazuara në ligj e në prova.*”.

3. Kundër vendimit të shkallës së parë ka paraqitur ankim pala e paditur në proces, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, ka konstatuar se hyrja në fuqi e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, për sa kohë që u ka njohur punonjësve të policisë statusin e nëpunësit civil, i ka siguruar mbrojtje ligjore të drejtës së rikthimit në strukturat e Policisë së Shtetit të punonjësve të liruar apo përjashtuar padrejtësisht nga këto struktura. Sipas nenit 3 të ligjit nr. 152/2013: “*Punonjësi i policisë dhe punonjësi i shërbimit të jashtëm është nëpunës civil, ndaj të cilëve zbatohet ky ligj, për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm.*”. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë (gjykata referuese), duke vlerësuar se fjalia “*për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm*” është e papajtueshme me Kushtetutën, me vendimin e datës 16.5.2016 ka pezulluar gjykimin e çështjes dhe i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese për kontrollin e kushtetutshmërisë së përmbajtjes së normës.

II

4. **Gjykata referuese** në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar këto argumente përpara Gjykatës:

4.1 Vendimi unifikues nr. 31/2003 i Gjykatës së Lartë, të cilit i është referuar gjykata e shkallës së parë për zgjidhjen e çështjes, është marrë në kohën kur ishte në fuqi ligji nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe mbeti i zbatueshëm edhe me hyrjen në fuqi të ligjit të ri



“Për Policinë e Shtetit”, nr. 9749, datë 4.6.2007, i cili la në fuqi të njëjtat elemente në lidhje me statusin e punonjësit të policisë. Por pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, vendimi unifikues nuk mund të përbente referim detyrues.

4.2 Me vendimin nr. 730, datë 6.3.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka konkluduar se ligji nr. 152/2013 është i zbatueshëm për të gjitha subjektet që janë pjesë e marrëdhënies së shërbimit civil dhe i shtrin efektet e tij nga data 1.10.2013 për të gjitha çështjet që janë duke u shqyrtuar nga gjykatat, për sa kohë që për këto çështje nuk ka ende një vendim të formës së prerë. Për pasojë, ky ligj gjen zbatim edhe për konfliktet gjyqësore të iniciuara nga ish-punonjës të Policisë së Shtetit. Por me vendimin nr. 276, datë 7.5.2015 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm, duke vlerësuar se punonjësit e policisë përjashtohen nga zbatimi i ligjit nr. 152/2013 dhe se në rastet e mosmarrëveshjeve të lindura përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit” zbatohen rregullimet që përmban ligji i vjetër nr. 9749/2007.

4.3 Gjykata referuese vlerëson se me ligjin nr. 152/2013 nëpunësit e policisë u përfshinë në kategorinë e nëpunësve civilë dhe nuk ka asnjë rrethanë që t’i përjashtojë nga zbatimi i këtij ligji. Mënyra e ndryshme e të trajtuarit të kësaj kategorie lidhet me mënyrën e formulimit të fjalisë së dytë të paragrafit të parë të nenit 3 të ligjit nr. 152/2013, e cila ishte e panevojshme dhe e pajustificueshme. Nëpërmjet të njëjtit paragraf të nenit 3 ligjvënësi u njeh dhe u garanton këtyre punonjësve statusin e nëpunësit civil, duke ia kufizuar njëherësh në fjalinë e dytë të këtij paragrafi. Përmbajtja e fjalisë “...për aq sa nuk parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm” në nenin 3 kufizon pa asnjë arsye një të drejtë të njohur punonjësve të Policisë së Shtetit në të njëjtin paragraf nëpërmjet fjalisë: “Punonjësi i policisë dhe punonjësi i shërbimit të jashtëm është nëpunës civil, ndaj të cilëve zbatohet ky ligj...”, çka bie në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës.

4.4 Nëpërmjet mënyrës së paqartë dhe kontradiktore të formulimit të nenit 3 është cenuar parimi i sigurisë juridike, për sa kohë që fjalia e kundërshtuar përkeqëson situatën juridike

të këtyre punonjësve, duke u hequr në fjalinë e dytë një të drejtë të konfirmuar në fjalinë e parë të së njëjtës dispozitë.

5. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar sa vijon:

5.1 Gjykata referuese në mënyrë të gabuar kërkon ta zgjidhë çështjen e saj bazuar në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, pasi: a) ky nuk është ligji i zbatueshëm për çështjen, duke qenë se ka parashikuar mundësinë e rregullimeve të posaçme me ligjin sektorial; dhe b) ligji sektorial i zbatueshëm në këtë rast është ligji nr. 9749/2007, “Për Policinë e Shtetit”. Pra, duke mos referuar ligjin e zbatueshëm në këtë rast, gjykata referuese nuk legjitimohet në ngritjen e këtyre pretendimeve.

5.2 Gjykata referuese *dubet të parashtrrojë arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtij ligji (të një ose të disa dispozitave të tij), duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës*. Duke analizuar në tërësi kërkesën e gjykatës referuese nuk rezulton që ky kusht të jetë plotësuar.

5.3 Gjykata referuese ka dështuar në dhënien e arsyeve serioze për antikushtetutshmërinë e normës objekt gjykimi. Vlerësimet e saj janë më shumë të karakterit personal dhe nuk bazohen në parime apo norma kushtetuese. Në kërkesë mungon një analizë e thellë e argumenteve se përse norma përkatëse shfaq probleme antikushtetutshmërie.

5.4 Arsyeja se përse ligjvënësi ka zgjedhur një parashikim të tillë, pra duke i njohur statusin e nëpunësit civil, por duke i lënë legjislacionit që të rregullojë në mënyrë sa më të plotë, por edhe të ndryshme statusin e punonjësve të policisë, lidhet me natyrën e ndryshme të punës që kryejnë nëpunësit civilë të mirëfilltë dhe punonjësit e policisë.

5.5 Po kështu, ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, aktualisht në fuqi, në nenin 6, pika 16, përcakton: ““Punonjës policie” është personi i emëruar në strukturat e policisë pas përfundimit të arsimit policor që mban gradë policore”. Nga analiza e këtyre përkufizimeve, por edhe tërësore e ligjeve përkatëse (ligji nr. 152/2013, ligji nr. 9749/2007 dhe ligji nr. 108/2014), rezulton se natyra e punës së nëpunësve civilë në administratën publike dhe natyra e punës së punonjësve të policisë, si dhe rregullimi juridik i marrëdhënies së tyre janë krejtësisht të ndryshme.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e gjykatës referuese

6. Gjykata referuese legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese nëse plotëson kushtet e parashikuara nga neni 145/2 i Kushtetutës dhe neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese". Neni 145/2 i Kushtetutës u njeh të drejtën gjyqtarëve që në çdo fazë të gjykimit, kur ata çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, të mos i zbatojnë ato, duke vendosur pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj Gjykatës Kushtetuese. Përmbajtja e kësaj dispozite ka të bëjë me kontrollin kushtetues të ligjeve të realizuar nga Gjykata Kushtetuese, por që për iniciues ka gjykatat e sistemit të zakonshëm, të cilat pezullojnë gjykimin kur gjatë shqyrtimit të një çështjeje gjyqësore ende të pazgjidhur, përfundimi i së cilës varet nga ligji konkret, çmojnë se ligji nuk është i pajtueshëm me Kushtetutën.

7. Gjykata ka vlerësuar që gjykata referuese të legjitimohet gjatë një kontrolli incidental të normës ligjore për papajtueshmëri me Kushtetutën, duhet që gjatë procesit gjyqësor: i) të ketë përcaktuar/identifikuar ligjin që do të zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete; ii) të ketë parashtruar arsye serioze për antikushtetutshmërinë e këtij ligji, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës; iii) të ketë krijuar bindjen se gjykimi nga ajo nuk mund të përfundojë në mënyrë të pavarur nga gjykimi në Gjykatën Kushtetuese; iv) të ketë hetuar nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe nëse arrin në konkluzionin se ky është ligji i vetëm të cilit duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 26, datë 22.5.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në kuptim të legjitimitimit për iniciimin e kontrollit incidental nuk është i mjaftueshëm vetëm identifikimi i lidhjes së drejtpërdrejtë, pra të provuarit se dispozita e kundërshtuar do të zbatohet në çështjen konkrete, por është po aq e rëndësishme që vendimi për pezullimin e çështjes dhe dërgimin e saj në Gjykatë të arsyetohet edhe nga pikëpamja e bazueshmërisë së çështjes në

lidhje me parametrat kushtetues të referuar si të cenuar nga dispozita e kundërshtuar. Gjykata referuese, në zbatim të parimit të kushtetutshmërisë, përpara se t'i drejtohet Gjykatës duhet të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar ligjin e zbatueshëm në përputhje me Kushtetutën (*shih vendimin nr. 55, datë 21.7.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Është detyrim i gjykatës referuese të zgjidhë dyshimet interpretative, duke i dhënë normës së zbatueshme një interpretim që përputhet me parimet kushtetuese. Në këto kushte, gjyqtari referues është i detyruar të zbatojë, midis interpretimeve të ndryshme të mundshme, atë që konsiderohet se përputhet me parimin kushtetues, që në të kundërt do të cenohej. Vetëm në rast se gjyqtari vlerëson se të gjitha interpretimet e mundshme bien në kundërshtim me Kushtetutën, atëherë ai duhet t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar kontrollin e kushtetutshmërisë së normës të individualizuar si e zbatueshme në rastin konkret (*shih vendimin nr. 4, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata ka theksuar se bazuar në nenin 131 të Kushtetutës në juridiksionin kushtetues hyjnë papajtueshmëria e ligjeve dhe akteve normative të organeve qendrore e vendore me Kushtetutën dhe marrëveshjet ndërkombëtare, kurse mënyra e të kuptuarit, e të zbatuarit të ligjit dhe e harmonizimit ndërmjet dispozitave të tij me ligje të tjera nuk janë çështje që i përkasin kontrollit kushtetues dhe, për rrjedhojë, nuk janë objekt shqyrtimi nga Gjykata Kushtetuese (*shih vendimin nr. 2, datë 3.2.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret rezulton se gjykata referuese është vënë në lëvizje për të shqyrtuar ankimin kundër vendimit të gjykatës administrative, e cila ka shqyrtuar padinë me objekt anulimin e urdhrit nr. 3538, datë 2.12.2013 të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit për lirimin e palës paditëse nga detyra, si edhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë padrejtesisht, duke vendosur në përfundim të gjykimit pranimin e pjesshëm të padisë në lidhje me dëmshpërblimin dhe rrëzimin për pjesën tjetër. Në gjykimin e ankimit kundër këtij vendimi gjykata referuese ka vlerësuar se në rastin konkret, për zgjidhjen e çështjes, është i zbatueshëm ligji për statusin e nëpunësit civil, i cili zbatohet edhe ndaj nëpunësve të policisë,



duke u njohur garancitë e nëpunësit civil, përfshirë edhe rikthimin në detyrë. Sipas saj, ky status i njihet kësaj kategorie punonjësish nga neni 3 i ligjit nr. 152/2013, i cili edhe pse në fjalinë e parë të paragrafit të parë i konsideron nëpunës civilë edhe punonjësit e Policisë së Shtetit, në fjalinë e dytë ua mohon këtë të drejtë. Për këtë arsye ajo ka vlerësuar se përmbajtja e nenit 3 të ligjit nr. 152/2013 bie ndesh me nenin 17 të Kushtetutës dhe parimin e sigurisë juridike.

11. Parimi i sigurisë juridike kërkon domosdoshmërisht një formulim të qartë të normave ligjore, pasi një rregullim i pasaktë i normës ligjore, që i lë shteg zbatuesit për t'i dhënë asaj kuptime të ndryshme dhe me pasoja, nuk shkon në përputhje me qëllimin, stabilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin që synon vetë norma juridike. Është kërkesë e parimit të sigurisë juridike fakti se një ligj në tërësi, pjesë apo dispozita të veçanta të tij në përmbajtjen e tyre duhet të jenë të qarta, të përcaktuara dhe të kuptueshme. Prandaj është detyrë e gjykatave ose organeve të tjera shtetërore e shoqërore, të ngarkuara me ligj, që mangësi të caktuara të një ligji t'i plotësojnë natyrshëm përmes interpretimit dhe zbatimit të tij në praktikë. Por që të realizohet një gjë e tillë, para së gjithash ligji duhet kuptuar saktë dhe drejtë. Prandaj duhet të dalë qartë qëllimi i hartimit të tij. Ai duhet të përcaktojë mjetet e ndërhyrjes, subjektet të cilave u drejtohet, raportet e caktuara të sjelljes dhe mënyrën e zbatimit të tij. Rezultati që synohet duhet të jetë i pritshëm dhe pasojat të parashikueshme për subjektet të cilave u drejtohet ligji në tërësi ose dispozita të veçanta të tij (*shih vendimet nr. 34, datë 20.12.2005; nr. 31, datë 19.11.2003 të Gjykatës Kushtetuese*). Për të zbatuar drejt këtë parim kërkohet, nga njëra anë, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të, dhe, nga ana tjetër, të mos qëndrojnë statik nëse duhet t'i japë formë një koncepti, siç është ai i drejtësisë në një shoqëri që ndryshon me shpejtësi (*shih vendimin nr. 36, datë 15.10.2007 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Bazuar në standardet e mësipërme, Gjykata vlerëson se gjykata referuese nuk e ka ngritur kërkesën në nivel kushtetues, duke mos paraqitur argumente bindëse dhe arsye serioze

për sa i përket cenimit të parimeve kushtetuese të sanksionuara në nenet 4 dhe 17 të Kushtetutës. Pretendimet e saj në thelb kanë të bëjnë me identifikimin e ligjit të zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes konkrete, si edhe mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të tij, konkretisht të nenit 3 të kundërshtuar, çka është një detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe nuk përbën objekt të juridiksionit kushtetues. Në këtë kuptim, Gjykata rithekson qëndrimin se është e domosdoshme që gjykata referuese përpara se të pezullojë procesin gjyqësor dhe të kërkojë kontrollin incidental të normës juridike, duhet të verifikojë nëse ka dispozita të tjera për të zgjidhur çështjen në gjykim dhe nëse nuk ka, të bëjë të gjitha përpjekjet për ta interpretuar atë në përputhje me Kushtetutën, me qëllim garantimin e dhënies së drejtësisë efektive. Për rrjedhojë, gjykata referuese nuk ka plotësuar kërkesat për legjitimitimin e saj për iniciimin e kontrollit incidental të normës.

13. Për sa u përket pretendimeve që lidhen me përplasjet apo kundërshtitë që ka norma e kundërshtuar me vendimet e Gjykatës së Lartë apo vendimin unifikues (në lidhje me punonjësit e policisë), Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjeve është kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe sidomos e Gjykatës së Lartë. Në këtë kuptim, Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme. Ky funksion ushtrohet nga Gjykata e Lartë duke tërhequr për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara. Kjo vjen si pasojë e pozicionit të saj si organi më i lartë i sistemit gjyqësor dhe lidhet me funksionin e përgjithshëm të saj për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit, të cilave gjyqtarët duhet t'u përmbahen (*shih vendimin nr. 6, datë 17.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i gjykatës referuese se fjala e dytë e paragrafit të parë të nenit 3 të ligjit nr. 152/2013 bie ndesh me Kushtetutën është i pabazuar. Për pasojë, Gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga gjykata referuese duhet të rrëzohet.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 134/1/dh dhe 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 68, 69, 70 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Altina Xhoxhaj, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo

NJOFTIM

I MINISTRISË SË PUNËVE TË JASHTME

Nr. 820, datë 20.1.2017

MBI HYRJEN NË FUQI TË DISA
MARRËVESHJEVE NDËRKOMBËTARE

1. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbi procedurat e sigurisë për shkëmbimin dhe mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, nënshkruar më 3.3.2016, hyrë në fuqi më 1.9.2016.

2. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Shkëmbimin e Informacionit mbi Verifikimin e Terrorizmit, nënshkruar më 14.4.2016, hyrë në fuqi më 14.9.2016.

3. Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shtetit të Kuvajtit për Bashkëpunimin në Fushën e Shëndetësisë, nënshkruar më 19.11.2014, hyrë në fuqi më 17.11.2016.

4. Memorandum bashkëpunimi në fushën e integritetit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë, nënshkruar më 17.5.2016, hyrë në fuqi më 17.11.2016.

5. Protokoll ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit Federal Zviceran, i cili amendon Konventën e datës 12 nëntor 1999, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për shmangien e taksimit të dyfishtë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, nënshkruar më 9.9.2015, hyrë në fuqi më 1.12.2016.

6. Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për mbrojtjen shoqërore dhe Marrëveshje Administrative për zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Çeke për mbrojtjen shoqërore, nënshkruar më 13.10.2015, hyn në fuqi më 1.2.2017.

7. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe për nxitjen dhe mbrojtjen e investimeve, nënshkruar më 15.10.2015, hyn në fuqi më 17.2.2017.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Gazmend Barbullushi

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë